




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME

Komisioni për hartimin e rregull. të punës së KK dhe Komiteteve
Nr.01-610/01-706/23 datë:06.01.2023



Npi – 01/04 datë: 11.01.2022

Komisioni për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për 2023, për mbledhjen e mbajtur më 11.01.2023, nxori këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

TË MBLEDHJES SË -I- KOMISIONI PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2023

Mbledhja është mbajtur më: 11.01.2023 (e mërkurë) në ora: 14.00h në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit.

Në mbledhje përveç Kryesuesit të Kuvendit z.Adnan Ademi dhe anëtarëve të Komisionit, znj.Sanie Sadiku dhe znj.Rrezartë Ramadani. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komisionit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023.
2. Propozim – Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimitisht miratoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Si draft e kemi planin e punës nga viti i kaluar 2022. Po fillojmë me rend sipas muajve, dhe po e hapi diskutimin.

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimitisht vendosi për muajin Janar që të jenë 6 pika si vijon:**

MUAJI JANAR – 2023

1. Raporti financiar për vitin 2022,
2. Draft -Plani i Punës të Kuvendit për Vitin 2023,
3. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit për 2023,
4. Raporti i punës të KKSB-së për vitin 2022,
5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023,
6. Raport i punës së Kuvendit për vitin 2022, nga Kryesuesi i Kuvendit,

MUAJI SHKURT – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimitisht vendosi për muajin Shkurt që të jenë 3 pika si vijon:**

1. Informatë nga DKA për përfundimin e gjysëm-vjetorit të parë shkollor 2023/24
2. Informatë nga DPUKGGJ lidhur me legalizimin e objekteve pa leje ndërtimi,
3. Raport-Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.

MUAJI MARS – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Mars që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual,
2. Miratimi i Planit të Integritetit,
3. Informatë për Implementimin e Planit të MSA-së,
4. Informatë për Planin e Punës të Drejtorisë të Prokurimit.

MUAJI PRILL - 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Prill që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për periudhën 3 mujore Janar-Mars 2023,
2. Informatë nga DZHE për zhvillimin ekonomik të Komunës,
3. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria e Prokurimit,
4. Informatë e përgjithshme nga DSHMS (me theks, Lista e barnave esenciale)

MUAJI MAJ - 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Maj që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Informatë nga DZHE – Sektori i bujqësisë për mbjelljet pranverore,
2. Informatë lidhur me përmbajtjen e Qarkores së parë Buxhetore nga M.F,
3. Informatë e përgjithshme nga DKRS,
4. Vizitë pune ose shkëmbim përvojash të Kuvendit brenda ose jashtë vendit,

MUAJI QERSHOR - 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Qershor që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026,
2. Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2023,
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022,
4. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për inovacion.

MUAJI KORRIK – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Korrik që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për periudhën 6 mujore Janar-Qershor 2023,
2. Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollorë 2023/24,
3. Informatë mbi raportin e performancës së Komunës,
4. Informatë nga KKSBB për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2023,

MUAJI GUSHT – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Gusht që të jenë 5 pika si vijon:**

1. Informatë lidhur me përmbajtjen e Qarkores së dytë Buxhetore nga M.F,
2. Draft-Buxheti i Komunës për vitin 2024 (diskutim publik),
3. Draft-Rregullorja komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024 (diskutim publik),
4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për tarifatatimore në vitin 2024,
5. Informatë nga DKA për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë 2024/25,

MUAJI SHTATOR – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Shtator që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Shqyrtimi i Draft-Buxhetit të Komunës për vitin 2024 (pas diskutimit publik),

2. Shqyrtimi Draft-Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024 (pas diskutimit publik),
3. Informatë nga DSHP lidhur me përgatitjet dimërore, dhe menaxhimin e mbeturinave,
4. Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm,

MUAJI TETOR – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Tetor që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për periudhën 9 mujore Janar-Shtator 2023,
2. Informatë nga DPUKGJ lidhur me implementimin e Investimeve Kapitale,
3. Informatë nga KRM “Pastërtia” Njësia në Shtime,
4. Informatë e përgjithshme nga Grupi Jo-formal i Grave,

MUAJI NËNTOR – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Nëntor që të jenë 4 pika si vijon:**

1. Informatë nga DZHE sektori i Bujqësisë (Me theks të veçante Subvencionet),
2. Informatë nga DPUKGJ lidhur me zbatimin e Planeve Zhvillimore Komunale,
3. Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit të punës dhe Orarit të mbledhjeve për 2024,
4. Informatë nga DSHMS (Me theks të veçante Kanceri i Gjirit).

MUAJI DHJETOR – 2023

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi për muajin Nëntor që të jenë 3 pika si vijon:**

1. Raport i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike-financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023,
2. Informatë mbi planin e punës të zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2024,
3. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit dhe Orarit të mbledhjeve për vitin 2024.

Pika 2

Propozim – Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2023

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Lexoi Propozim - Vendimin për caktimin e orarit të mbledhjeve për vitin 2023.

znj.Sanije Sadiki; Unë propozoj që mbledhjet e Kuvendit të mbahen në ora 09:00h.


znj.Rrezartë Ramadani; Unë jam për ora 10:00h, por nëse keni votuar në ora 09:00h edhe unë jam që të jetë në ora 09:00h.

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi ti rekomandoj Kuvendit miratimin e Planin të Punës të Kuvendit për vitin 2023.**

*** Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023 , unanimisht vendosi ti rekomandoj Kuvendit miratimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2023.**

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e Komisionit e përfundoi në ora 16.08 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

